



UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 18, datë 20.07.2017

“Për një ndryshim në Vendimin e Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës Nr.35, datë 25.05.2009 “Për miratimin e modelit të diplomave të lëshuara nga Universiteti i Tiranës”

Bazuar në Ligjin Nr.80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*, neni 91; në Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 20, si dhe në Udhëzimin Nr.5, datë 18.02.2009 *“Për përmbajtjen dhe formën e Diplomës së lëshuar nga IAL”* i ndryshuar, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 20.07.2017;

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet në formën e diplomave të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, sipas formave bashkëlidhur.
2. Një kopje e këtij Vendimi t'i përcillet për procedura të mëtejshme Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA).
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

PROF.DR. MYNYR KONI